



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 tetor 2013
Nr. ref.:RK480/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI87/13

Parashtruese

Fatmire Azemi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. nr. 13/2010, të 4 shkurtit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është parashtruar nga Fatmire Azemi me vendbanim në Podujevë. Parashtruesja nuk është e përfaqësuar.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 13/2010, të 4 shkurtit 2013.
3. Ky vendim i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 29 prill 2013.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesja e kërkesës ankohet se asaj i ishte ndarë gjysma e pronës së përbashkët nga gjykatat e rregullta në instancën e parë dhe të dytë, por gjykatat refuzuan t'i ekzekutojnë këto vendime gjyqësore. Kërkesa nuk përmend asnjë nen konkret të Kushtetutës në lidhje me shkeljet e pretenduara.

Baza ligjore

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 qershor 2013, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 19 qershor 2013, Kryetari caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama.
8. Më 9 korrik 2013, Sekretariati e njoftoi parashtruesen dhe Gjykatën Supreme lidhur me kërkesën.
9. Më 13 shtator 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Ndërmjet viteve 1992 dhe 2004, parashtruesja kishte jetuar në një 'bashkësi jashtëmartesore' me I.G. Çifti kishte dy fëmijë. Në një moment, në vitin 2004, 'bashkësia jashtëmartesore' ishte ndërprerë. Parashtruesja e fitoi kujdestarinë për dy fëmijët e saj.
11. Më 27 dhjetor 2006, parashtruesja paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër të paditurit I.G., duke kërkuar gjysmën e pronës së përbashkët të fituar gjatë 'bashkësisë jashtëmartesore', prej 1992 deri më 2004.
12. Parashtruesja pretendonte se bazuar në kontributin e saj në 'bashkësinë e tyre jashtëmartesore', ajo kishte të drejtë në gjysmën e fitimeve të kompanive afariste të bashkëshortit të saj, dhe në gjysmën e vlerës së pronës së paluajtshme, të blerë gjatë asaj kohe. Parashtruesja e kishte bazuar pretendimin e saj në faktin se gjatë marrëdhënies së tyre, parashtruesja ishte përkujdesur për prindërit e të paditurit dhe për vetë të paditurin, duke i lënë kohë të

mjaftueshme të paditurit që t'i themelojë dy kompani afariste, "Deluxe Commerce" dhe "Kristal Glass".

13. Më 15 nëntor 2007, Gjykata Komunale me Aktgjykimin C. nr. 2787/06, i aprovoi pjesërisht pretendimet e parashtrueses. Gjykata Komunale kishte mbajtur seancën në të cilin nuk ishte paraqitur i padituri. Gjykata Komunale e bazoi Aktgjykimin e saj në ekspertizën financiare të përgatitur me urdhrin e Gjykatës Komunale.
14. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Komunale i kishte ndarë Parashtrueses "[...] gjysmën e fitimit të arritur prej aktivitetit të PTE "Deluxe Commerce", të themeluar nga i padituri, në shumën prej €118,269.89". Gjykata Komunale e kishte urdhëruar parashtruesen "të paguajë shumën e ndarë dhe shpenzimet procedurale në shumën prej €556.60 në afat prej 15 ditësh nga nxjerrja e Aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm." Gjykata Komunale i refuzoi si të pabazuara pretendimet e parashtrueses së kërkesës, në gjysmën e pjesës së pronës së paluajtshme prej 50 ari (100 m²), e cila gjendet në fshatin Doberdol, komuna e Podujevës, gjysmën e pjesës së pronës në Llapnasellë, prej 53 ari, si dhe gjysmën e vlerës së kamionit dhe gjysmën e vlerës së automjetit "Volkswagen Passat".
15. Kundër këtij aktgjykimi të Gjykatës Komunale, i padituri, I.G., kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke pohuar se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale ishte nxjerrë duke u bazuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 30 tetor 2009, Gjykata e Qarkut, me Aktgjykimin Ac. nr. 230/2008, e refuzoi si të pabazuar ankesën dhe e konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.
17. Më 24 nëntor 2009, parashtruesja kishte iniciuar procedurë për ekzekutim në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar nga ajo që ta urdhërojë të paditurin I.G. që, "të paguajë shumën prej €118,269.89, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej €556.50, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore siç janë llogaritur nga gjykata, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm".
18. Pala e paditur, I.G., paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. I padituri kishte pretenduar se Gjykata e Qarkut kishte bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe e kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale. I padituri kishte kërkuar që të prishen të dy aktgjykimet dhe rasti të kthehet në gjykatën e instancës së parë.
19. Më 4 shkurt 2013, Gjykata Supreme, me Vendimin Rev. nr. 13/2010, "e aprovoi revizionin e të paditurit dhe e prishi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 230/2008, të 20 tetorit 2009 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2787/06, të 15 nëntorit 2007, dhe e ktheu rastin në instancën e parë për rigjykim". Gjykata Supreme arsyetonte se situata faktike nuk ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

20. Gjykata Supreme arsyetoi se:

”Në bazë të nenit 307 par. 1 dhe 2 të Ligjit mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare, është paraparë se pasuria të cilën bashkëshortët e kanë fituar me punë dhe gjatë ekzistimit të bashkësisë martesore si dhe të hyrat nga kjo pasuri është pasuri e përbashkët e tyre, e këtë e përbëjnë të gjitha të drejtat reale dhe detyrimet. Në nenin 325 të ligjit në fjalë, është paraparë se marrëdhëniet e bashkëshortëve jashtëmartesorë në analogji zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve. Sipas dispozitave në fjalë, për ekzistimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve duhet të plotësohen dy kushte: a) puna dhe b) bashkësia martesore. Puna mund të jetë e përbashkët dhe individuale si dhe puna direkte dhe indirekte. Me rastin e vërtetimit të kontributit të bashkëshortëve, duhet të vlerësohen të gjitha rrethanat, si të ardhurat personale, ndihma e njërit bashkëshort bashkëshortit tjetër, udhëheqja e punëve shtëpiake, kujdesi për fëmijë dhe mirëmbajtja e pasurisë. Gjykata e shkallës së parë kontributin e pasurisë së përbashkët të ndërgjyqësve ka vlerësuar se është në pjesë të barabartë, e jo sipas kontributit. Me rastin e vërtetimit të kontributit të bashkëshortëve, duhet vlerësuar të gjitha rrethanat, të ardhurat personale, ndihmën e bashkëshortit ndaj bashkëshortit tjetër, udhëheqja e punëve shtëpiake, kujdesi për fëmijë dhe mirëmbajtja e pasurisë, të cilat nuk vlerësohen në mënyrë të gjithanshme nga gjykata e instancës më të ulët, sepse kontributi i paditëses është në pjesë të barabartë. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë nuk bën vlerësimin dhe nuk jep asnjë arsye bindëse se çka konsideron kontributin e paditëses në fitimin nga biznesi të cilin e ka udhëhequr i padituri, por pjesëtimin e saj në bazë të kontributit që bën pjesë të barabartë, e JO në bazë të kontributit. Prandaj, gjykata e shkallës së parë në rivendosje në këtë çështje juridike duhet të vlerësojë të gjitha rrethanat gjatë caktimit të kontributit të paditëses në fitimin nga veprimtaria e biznesit, e që është regjistruar dhe udhëhequr nga ana e të paditurit, duke marrë parasysh se i padituri ka udhëhequr biznesin në firmën "Delux Commerce", sa ka qenë ndihma e paditëses në të ardhurat prej biznesit në fjalë, sa ka qenë kontributi i paditëses në të hyrat e kësaj firme, me punët shtëpiake, në kujdesin e fëmijëve dhe mirëmbajtjen e pasurisë, e pas kësaj gjykata të caktojë pjesën në bazë të kontributit të paditëses”.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesja pretendon se edhe pse Gjykata Komunale në Prishtinë e kishte nxjerrë Aktgjykimin e saj (C. nr. 2787/06), më 15 nëntor 2007, duke i aprovuar pjesërisht pretendimet e saj, dhe edhe pse ky aktgjykim ishte konfirmuar më 20 tetor 2009 (Ac. nr. 230/2008) nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përmbarimi i tij nuk ishte kryer, përkundër kërkesave të saj të vazhdueshme për informata nga Gjykata.
22. Parashtruesja më tutje pretendon se Gjykata Supreme i kishte prishur aktgjykimet e Gjykatës Komunale (C. nr. 2787/06) dhe të Gjykatës së Qarkut (Ac. nr. 230/2008), respektivisht, 5 vjet pas aktgjykimit fillestar.

23. Parashtruesja e kërkesës ankohet se: *“Kundër meje dhe dy vajzave të mitura, është ushtruar dhunë fizike dhe psikike, nuk kemi as ushqim dhe as vend për të jetuar dhe të drejtat tona themelore janë shkelur, e drejta e njeriut për të jetuar ishte shkelur dhe pjesa që më takonte mua, si bashkëshorte, dhe dy vajzave të mia ishte marrë.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses, Gjykatës i nevojitet, së pari, të shohë nëse parashtruesja i plotëson kriteret e pranueshmërisë të parapara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

25. Neni 113 (1) dhe (7) i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme në mënyrë që kërkesa të konsiderohet e pranueshme:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Neni 47 (2) i Ligjit, gjithashtu përcakton se:

“Individi mund ta ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Për më tepër, rregulli 36 (1) i Rregullores përcakton se:

“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

(a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.

28. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, siç është interpretuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (shih, nenin 53 të Kushtetutës), është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë edhe Gjykatën, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih, Rasti KI 41/09, parashtruesi i kërkesës AAB/RIINVEST Universiteti SH.P.K, Prishtinë, Aktvendim i 27 janarit 2010; gjithashtu, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).

29. Sa i përket rastit konkret, parashtruesja kishte parashtruar kërkesë duke e kontestuar mosekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë

(C. nr. 2787/06), duke argumentuar se e drejta e saj për të jetuar dhe për të përfituar nga gjysma e pjesës së pasurisë së përbashkët, e cila i kishte takuar asaj dhe dy vajzave të saj, i ishte marrë. Parashtruesja nuk thirret në asnjë nen të Kushtetutës ose të KEDNJ-së.

30. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës Supreme (Rev. nr. 13/2010) kishte gjetur mangësi në zbatimin e ligjit dhe në identifikimin e fakteve në aktgjykimet e gjykatave të instancës së parë dhe të dytë. Gjykata Supreme e ktheu prapa lëndën në tërësi në gjykatën e instancës së parë për rishqyrtim të plotë.
31. Në këto rrethana, Gjykata gjen se çështja është ende në procedurë në gjykatat e rregullta. Pretendimi i parashtrueses mbetet për t'u adresuar në këtë procedurë të rihapur në gjykatat e rregullta.
32. Nga kjo rrjedh se parashtruesja nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me rregullin 36 (1) (a) të Rregullores, dhe kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullat 36.1 dhe 56.2 të Rregullores së punës, më 13 shtator 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani